

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR PËRSHKRIMIN E MATERIALEVE SIPAS RREGULLAVE ANGLO-AMERIKANE (AACR2).

- [1.0 – Rregulla të përgjithshme](#)
- [1.0C - Pikësimi](#)
- [1.0E - Gjuha dhe alfabeti gjatë përshkrimit](#)
- 1.0G - Theksi dhe shenjat e tjera diakritike
- [1.1B - Titulli kryesor](#)
- [1.1B1 - Titulli kryesor](#)
- [1.1B8 - Titulli kryesor](#)
- [1.1B9 – Titulli kryesor si plotësim, apo pjesë e një burimi tjetër](#)
- [1.1D1 – Titujt paralel](#)
- [1.1D2 – Titujt paralel](#)
- [1.1E2 – Nëntitulli](#)
- [1.1E5 – Nëntitulli](#)
- [1.1F1 – Personat përgjegjës](#)
- [1.1F2 - Personat përgjegjës](#)
- [1.2B1 –Ribotimi](#)
- [1.4C6 - Vendi i botimit, shpërndarjes, etj.](#)
- [1.4F1 – Data e botimit, shpërndarjes, etj.](#)
- [1.4F6 - Data e botimit, shpërndarjes, etj.](#)
- [1.5D - Dimensionet](#)
- [1.6B1 – Titulli kryesor i serive \(koleksioneve\)](#)

1.0 – Rregulla të përgjithshme

Ribotim apo kopje

Për të përcaktuar nëse një manifestim i ri i një njësie është kopje e një manifestimi më të hershëm apo një ribotim i veçantë nga manifestimi i mëhershëm, pasi kështu duhet të krijohet një njësi re bibliografike, konsultohu me definicionin e “Ribotimit” në shtojcën D. Nëse, sipas këtij definicioni, dy njësi dalin që janë dy ribotime të ndryshme, krijo njësi të veçanta bibliografike për secilën.

Po ashtu, shqyrto manifestimin e ri të njësisë të jetë një ribotim i veçantë nëse njera prej elementeve të mëposhtme mund të thuhet për të:

1) ka tregues të qartë se ka ndodhur ndryshim (duke përfshirë edhe korrigjimet) në përmbajtje;

2) çdo gjë në zonat vijuese apo në elementet e zonave vijuese ndryshon nga një njësi bibliografike në tjetrën: zona e titullit dhe e personave përgjegjës, zona e ribotimit, zona e përshkrimit fizik, sa i përket faqeve apo masave të tjera të aplikuara në këtë element, dhe zona e serisë (koleksionit); ose:

3) për muzikën e shtypur dhe incizimet zanore, kurdoherë që dy njësi kanë numra të ndryshëm të botuesit apo të licencimit.

Megjithatë, shqyrto një manifestim të ri të jetë kopje e një manifestimi të mëhershëm nëse i vetmi ndryshim është në zonën e botimit, shpërndarjes, etj., apo atë të ISBN-ve, dhe se ndryshimi gjendet në një apo më shumë elemente në vijim:

- 1) një ndryshim në datën e të drejtës autoriale kur ka edhe datë të botimit;
- 2) ndryshim në datën e shtypjes;
- 3) ndryshim shumë i vogël në emrin e entitetit, i cili përdoret vazhdimisht, p.sh., St. Martin's dhe St. Martin's Press. Mos e konsidero këtë si ndonjë ndryshim thelbësor;
- 4) shtimi, heqja, apo ndryshimi i një ISBN-je; apo
- 5) ndryshimi në mënyrën e lidhjes.

Për të gjitha ndryshimet e ndodhura në zonën e botimit, shpërndarjes, etj., shqyrto njësinë të jetë ribotim i ri, p.sh., ndryshimet të cilat përfshijnë vende të ndryshme apo entitete të ndryshme, apo çfarëdo ndryshimi në emrin e entiteti që sugjeron ose një ndryshim emri apo një entitet të ndryshëm, p.sh., Harper & Brothers bëhet Harper & Row.

1.0C - Pikësimi

Interpretim

Brenda një pjese përshkuese të një njësie bibliografike zbato rregullat vijuese konvencionale për të lënë hapësirë pas përdorimit të pikës:

- 1) Mos lë hapësirë pas pikës së përdorur për të ndarë inicialet prej njëra-tjetrës.

... / by W.O. Raymond
Edmonton : L.U.L. Publications,
[1979]

- 2) Lë hapësirë pas përdorimit të pikës për të ndarë inicialet apo format e shkurtuara nga një fjalë, numër, apo shkurtesë tjetër, për të ndarë një formë të shkurtuar nga initiale pasuese, apo për të ndarë një grup inicialesh nga një grup tjetër.

Biseda me W.A.C. Bennett...

nr. 23

Ph. D.

M. J.P. Rabaut (i.e. Monsieur
J.P. Rabaut)

3) Lë dy hapësira pas përdorimit të pikës për të ndarë fjali brenda zonës së njëjtë apo për të ndarë elemente diskrete brenda një elementi apo zone (p.sh., për të ndarë titullin e veprës kryesore nga titulli i një pjese, apo për të ndarë titullin e një serie nga titulli i një nënserie).

Botime serike. Seri
monografike / Fakulteti i çështjeve
shoqërore, Universiteti i Torontos

4) Mos lë hapësirë midis shkronjave të veçanta të cilat nuk pasohen me pikë. P.sh:

XYZ

Përfundime

Nëse shkronjat e veçanta dihet se janë initiale të cilat paraqesin emra dhe/apo mbiemra, vendose pikën pas inicialeve dhe zbato rregullat për hapësira pas pikës siç janë cekur më lart.

Në burim:
nga T S Eliot
Transkriptimi:
nga T.S. Eliot

Nëse dy pika, shenja tërthore që paraqet pjesëtimin, apo shenja e barazimit paraqiten brenda një elementi, transkripto ato vetëm nëse hapësirat mund të mbyllen në të dy anët.

Dinner at 8:00
Study/workbook for knitting
2x2=5 : a farce in one act

Përndryshe zëvendëso me presje, vizë apo ndonjë shenjë tjetër e cila nuk është shenjë konvencionale për atë zonë në të cilën paraqitet elementi.

Në burim:
Symposium: Fine Arts in the 80's
Transkriptimi:
Symposium--Fine Arts in the 80's

Nëse hapësirat nuk mund të mbyllen, dhe nuk mund të bëhet një zëvendësim i kënaqshëm, thjesht hiqeni shenjën e pikësimit.

Për rregullat konvencionale për vënien e hapësirës dhe të shenjave të pikësimit të përdorura në përcaktuese, shih kapitujt 22, 23, 24 dhe 25.

1.0E - Gjuha dhe alfabeti gjatë përshkrimit

Interpretim

Kur bëhet përshkrimi i informacionit i paraqitur në alfabet latin, bëje përshkrimin e shkronjave ashtu siç janë dhënë, përveç si vijon:

- 1) Konverto format e mëhershme të shkronjave në formën e tyre moderne;
- 2) Për njësitë e botuara pas vitit 1820, konverto “v” në “u”, “vv” në “w” dhe “i” në “j” sipas nevojës për të reflektuar përdorimin modern.

Shih po ashtu interpretimin e rregullave [22.1B](#), [23.2A](#), [24.1](#), [25.2A](#).

1.0G - Theksi dhe shenjat e tjera diakritike

Interpretim

Shto theksin sipas nevojës në fjalët në frëngjishte edhe nëse shkronja mbi të cilën do të vendoset theksi është e shkruar me shkronjë të madhe.

Në burim:

Ecole polytechnique de Montréal

Transkriptimi:

École polytechnique de Montréal

Në burim:

Ecrits sur l'avenir

Transkriptimi:

Écrits sur l'avenir

Theksi mbi shkronjat e mëdha në iniciais dhe akronime në frëngjisht do të shkruhen ashtu si gjenden në përdorim. Për theksin dhe shenjat e tjera diakritike të përdorura në përcaktuese, shih kapitujt 22, 23, 24, 25.

1.1B – Titulli kryesor

Interpretim

Përdor gjykimin tuaj për të vendosur nëse një fjalë apo togfjalësh është pjesë e titullit kryesor apo është një element i nëntitullit. Në shumë raste, natyrisht, gjuha e përdorur do të mund t'i jap përgjigje kësaj çështje duke mos ofruar asnjë pushim mes elementeve.

Loan agreement between the
government of the United Kingdom
of Great Britain and Northern
Ireland and the government of the
Argentine Republic

Në raste të tjera burimi i informacionit mund të tregojë se ka pushim (zakonisht me një presje), mirëpo ajo që vjen pas pushimit është pjesë e pandarë e kuptimit të titullit.

Sincerely, Willis Wayde

Raste të tilla të qarta do të mbesin gjithmonë në gjykimin e kataloguesit, i cili do të bëjë dallimin mes titullit kryesor dhe nëntitullit, në bazë të gjuhës, kuptimit, mënyrës së paraqitjes, tipografisë, si dhe me paraqitjen e titullit në burime të ndryshme përveç atij kryesori, të cilët mund të shërbejnë si faktorë për t'i pasur parasysh.

1.1B1 – Titulli kryesor

Interpretim

Mos i transkriptoni (përshkruani) shkronjat apo simbolet e përdorura në titull të cilët paraqesin shenja tregu, leje patentash, të drejt autoriale, etj., përveç nëse ato paraqesin vetë titullin apo janë të integruara në titull në mënyrë të atillë që po të hiqen do të pasojë në dykuptimësi apo deformim të informacionit.

Në burim:

© copyright: how to register your
copyright

Transkriptimi:

Copyright : how to register your
copyright

Në burim:

A survey of SIMULA™ applications

Transkriptimi:

A survey of SIMULA applications

Shenjat e pikësimit, pjesë përbërëse e rregullave që paraqesin tituj alternativë, duhet të përshkruhet ashtu siç është. Nuk përcaktohet nga përdorimi i gjuhës dhe se përshkrimi i shenjave të pikësimit duhet të zbatohet për titujt në të gjitha gjuhët.

Me rastin zëvendësimit të tri pikave (...) brenda titullit kryesor me vizë të ndërprerë (--), lije një hapësirë pas vizës, përveç nëse viza është në fillim të titullit.

Nothing ventured-- : investing
in Canada's winners

--and so on : new designs for
teaching mathematics

Thonjëzat

Pasi rregulla 1.1B1 thotë që titulli kryesor duhet të përshkruhet “saktësisht fjalë për fjalë, si është i radhitur dhe drejtshkrimi, por jo domosdoshmërisht edhe shenjat e pikësimit dhe shkronjat e mëdha”, prandaj thonjëzat nuk përshkruhen zakonisht kur paraqiten në titullin kryesor. Po qe se mendohet që thonjëzat përbëjnë një pjesë thelbësore të titullit, atëherë ato duhet të përshkruhen. Thonjëzat gjithmonë duhet të përshkruhen si thonjëza të plota pa marrë parasysh se si paraqiten në titull. Nuk është e nevojshme që të bëhet ndonjë shpjegim i tyre në fushën e vërejtjeve.

Westlake's A study of "Singin' in the rain"

"Peace, order and good government" re-examined

1.1B8 – Titulli kryesor

Interpretim

Nëse paraqitet ndonjë dyshim i çfarëdo natyre të asaj se cila është “përmbajtja kryesore e shkruar, e folur apo e kënduar e një njësie”, (d.m.th. nëse mbizotërimi i një gjuhe apo alfabeti nuk mund të shquhet qartazi), zgjedh titullin kryesor sipas radhitjes së titulli, apo të paraqitjes së tij në burimin kryesor të informacionit.

Në raste të botimeve bilinguale në përbërje të tekstit në anglisht dhe frëngjisht me një mbizotërim të njëres prej gjuhëve, zgjedh titullin kryesor sipas radhitjes së titullin apo paraqitjes së tij në burimin kryesor të informacionit.

1.1B9 – Titulli kryesor si plotësim, apo pjesë të një burimi tjetër

Në vijim po i paraqesim disa rregulla të përgjithshme; situatat të cilat nuk janë të diskutuara këtu duhet të mbesin në gjykimin e kataloguesit.

Në përgjithësi, kur një pjesë plotësuese, apo pjesë të një burimi tjetër e ka një titull i cili nuk mund të identifikohet pa përfshirjen e titullit të përbashkët për të gjitha pjesët (apo edhe titullin në burimin kryesor) ashtu siç është paraqitur në burimin kryesor, përshkruaje së pari titullin e përbashkët (apo titullin e burimit kryesor), dhe merr parasysh titullin e njësive plotësuese apo të një pjesë (\$p).

245 \$aAdvanced calculus.\$pStudent handbook

245 \$aOn the road to justice, the Youth Criminal
Justice Act and aboriginal communities.\$pResources
for grades 6 and 7 students

E kur një pjesë plotësuese, apo pjesë të një burimi tjetër e ka një titull i cili mund të veçohet nga titulli i përbashkët i të gjitha pjesëve (apo titulli i burimit kryesor), merre parasysh titullin e pjesës plotësuese apo të pjesës si titull kryesor dhe trajtoje titullin e përbashkët (apo titullin e burimit kryesor) si seri nëse është e mundshme.

245 \$aValley Truss & Metal Ltd., converting on-site
wood waste into economic space heating
4xx \$aBiomass combustion systems

245 \$aMining and minerals
4xx \$aLaë of South Africa ; v. 18

1.1D1 – Titujt paralel

Interpretim

Në rastin e përshkrimit të titujve paralel, zbato rregullat e njëjta të përshkrimit që përdoren për titullin kryesor (shih 1.1B).

1.1D2 – Titujt paralel

Interpretim

Përshkruaje titullin (titujt) paralel në pajtim me rregullat sipas “Niveleve të përshkrimit”.

1.1E2 - Nëntitulli

Interpretim

Për njësitë të cilat i kanë dy vepra të të njëjti autorë pa ndonjë titull të përbashkët, dhe kur burimi kryesor i informacionit nuk është unifikues në natyrë, ndërsa nëntitulli është i përsëritur në të gjitha veprat te secili titull në burime të ndryshme të asaj njësie, përshkruaje nëntitullin vetëm njëherë duke e pasuar vetëm titullin e fundit kryesor.

Rose Marie [incizim zanor] ;
Indian love call : from the
musical play, Rose Marie / words
by Harbach, Hammerstein ; music
by Friml, Stothart.
(Nëntitulli është i paraqitur në të dy anët e diskut)

1.1E5 - Nëntitulli

Opsion

Shto nëntitullin në gjuhët e tjera sipas kriterëve të vendosura për llojin e materialit të të cilit i takon njësia e caktuar. Për më shumë hollësi shih .1E nën kapitullin përkatës.

1.1F1 – Personat përgjegjës

Nëse emri (emrat) personal, i cili duhet të përshkruhet në fushën e personave përgjegjës, fillon me mbiemër (apo ndonjë formë tjetër), përshkruaje emrin (emrat) ashtu si janë paraqitur. Megjithatë, pasi kjo mund të shpjerë në pështjellim sa i përket numrit dhe emrit (emrave) të individit (individëve), pasojë përshkrimin me një ripërshkrim të atij emri në formën e rregullt.

Le saumon atlantique :
utilisation et conservation,
pourquoi pas? / Bilodeau,
Gérard, Nadeau, Georges-André,
Shooner, Gilles [i.e. Gérard
Bilodeau, Georges-André Nadeau,
Gilles Shooner].

1.1F2 – Personat përgjegjës

Interpretim

Përfshij në fushën e vërejtjeve ndonjë person përgjegjës, i/e cila nuk paraqitet në mënyrë të dukshme në njësi po qe se paraqitet nevoja për të justifikuar përdorimin e tij/saj në ndonjë prej përcaktueseve kryesore apo shtesë.

Bourassa-Trépanier, Juliette
Jacques Héту. -- Don Mills, Ont. ...
Vërejtje:
Teksti nga Juliette Bourassa-Trépanier.

1.2B1 - Ribotimi

Interpretim

Nëse në një njësi gjendet informacion se është “botimi i parë” apo diçka e ngjashme, përshkruaje informacionin ashtu siç është paraqitur.

1.4C6 – Vendi i botimit, shpërndarjes, etj.

Interpretim

Nëse vendi i botimit, shpërndarjes, etj., nuk është vënë në emër, ose nëse vendi nuk dihet me siguri, përshkruaje emrin në formën standard - nëse ekziston, të pasuar me pikëpyetje.

[Toronto?]

[Drumheller, Alta.?)

1.4F1 – Data e botimit, shpërndarjes, etj.

Interpretim

Nëse data e cila është paraqitur në burimin të cilin e përshkruajmë si datë sipas kalendarit Gjeorgjian dhe atyre jo-Gjeorgjian, përshkruaje datën sipas kalendarit Gjeorgjian. Nëse data është e paraqitur vetëm në formë jo-Gjeorgjiane, përshkruaje datën ashtu siç është paraqitur, të pasuar në data në kalendarin Gjeorgjian në kllapa të mesme.

, 4308 [1975]

1.4F6 – Data e botimit, shpërndarjes, etj.

Interpretim

Nëse njësia përmban vetëm datën e të drejtës autoriale, përshkruaje atë datë.

Mos i përshkruani datat e ripërtëritjes së të drejtës autoriale. Mos i përshkruani datat e të drejtës autoriale, të cilat i përkasin vetëm një pjese të veprës, të tilla vetëm për parathënie, etj.

1.5D - Dimensionet

Gjatë përshkrimit të dimensioneve të një njësie që kërkon më shumë se një dimension, përdor shkronjën e vogël “x” si shenjë shumëzimi për të ndarë secilin dimension.

; 20 x 32 cm
; 48 x 30 cm, e paluar në 24 x 15 cm
; në mbështjellës 18 x 25 x 19 cm

1.6B1 – Titulli kryesor i serive (koleksioneve)

Interpretim

Emrat e korporatave si tituj të serive (koleksioneve)

Emri i një korporate përgjegjëse për një seri (koleksion) mund të përshkruhet si titull kryesor i asaj serie, nëse emri paraqitet në burim në lidhje me numërimin e njësisë brenda serisë dhe se nuk ka titull tjetër të paraqitur.

4xx \$aWinnipeg Art Gallery ;\$v6

Marrë dhe përkthyer: Bibliotekës dhe Arkivës së Kanadasë ([lidh këtë emër me link të jashtëm: http://www.collectionscanada.ca/6/18/s18-204-e.html](http://www.collectionscanada.ca/6/18/s18-204-e.html))

